



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI I KOMUNËS**

Në bazë të neneve 11, 12 paragrafi 2 shkronja d), nenit 17 shkronja f), nenit 40 paragrafi 2 shkronja l) të Ligjit nr.03/L-040, për vetëqeverisje lokale, në mbështetje të nenit 6 të Ligjit nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr-03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.05/L-009, konform nenit 4 lidhur me neni 5 të Rregullores Nr. 02/2013 mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrja e komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve rajonale të ujit, dhe neneve 14, 15 paragrafi 2.4, nenit 1.6, si dhe nenit 34 paragrafi 2.12 të statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2022, miratoi këtë:

### **VENDIM**

#### **PËR NISJEN E PROCEDURAVE PËR THEMELIMIN E NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE - NPL**

##### **Neni 1**

Me këtë Vendim, miratohet propozimi nr.01-300/01-0026534/22 i datës 12.04.2022 për nisjen e procedurave për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale-NPL në Komunën e Podujevës.

##### **Neni 2**

#### **Qëllimi dhe arsyeja**

1. Qëllimi i themelimit të Ndërmarrjes Publike Lokale-NPL në Komunën e Podujevës, është ofrimi i një game të re të shërbimeve publike dhe përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve duke ofruar shërbime efikase publike, rritje të punësimit dhe ekonomizimin e kostove të ofrimit të shërbimeve publike, si në vijim: *-Shërbimet e tregut; -Mirëmbajtje të varrezave; -Parkingje publike; -Mirëmbajtje të kanalizimeve; -Mirëmbajtje të shtretërve të lumenjve; -Dekorim të hapësirave publike; -Mirëmbajtje dimërore dhe verore të rrugëve; -Pyllëzim të sipërfaqeve publike; -Mirëmbajtje të ndriçimit publik, shërbime këto të cilat pjesa më e madhe e tyre nuk ofrohen fare në Komunën e Podujevës, ndërsa një pjesë e tyre ofrohen përmes kontraktimit të operatorëve ekonomik, dhe atë:*

- 1.1. Shërbimet të cilat synohet të ofrohen me këtë NPL, e që nuk ofrohen tani në Komunën e Podujevës, janë; *-Mirëmbajtja e varrezave dhe -Parkingu publik.*
- 1.2. Shërbimet të cilat ofrohen nga Komuna por përmes kontraktimit të operatorëve ekonomik privat, janë; *-Mirëmbajtja e kanalizimit; -Mirëmbajtja e gjelbërimit; -Mirëmbajtja e shtretërve të lumenjve; -Dekorimi i hapësirave publike; -Mirëmbajtja dimërore dhe verore e rrugëve; -Pyllëzimi i sipërfaqeve publike; -Mirëmbajtja e ndriçimit publik, shërbime për të cilat Komuna e Podujevës mesatarisht shpenzon rreth 400,000.00€ në vit.*

2. Arsyeja e themelimit të Ndërmarrjes Publike Lokale-NPL në Komunën e Podujevës, është ekonomizimi i kostove për ofrimin e shërbimeve publike si një prej dobive për tatimpaguesit si dhe ofrimi i shërbimeve për qytetarët të cilat tani nuk ofrohen.

### Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen organet përkatëse të Ekzekutivit të Komunës së Podujevës, të cilat ndërmarrin, bashkëpunojnë dhe koordinojnë të gjitha veprimet e nevojshme me nivelin qendrorë, në funksion të themelimit të Ndërmarrjes Publike Lokale, sipas propozimit përkatës bashkëngjitur këtij vendimi.

### Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, dhe nenit 8 lidhur me nenin 9 të Rregullores, nr.10/2019 për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr.06/2021, dhe pas shpalljes publike në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr.prot. 01-016/01-0030688/22  
Podujevë, datë, 29 prill 2022



Kryesuesi i Kuvendit  
Hilmi Hoxha